

Shkolla informon prindërit

## Skrajat anale

### Shkaktuesi dhe ngjitja

- Shkaktuesi është një krimb/skrajë e bardhë e gjatë 8-13 mm, e gjërë gadi një milimetër e quajtur *Entero Vermicularis*, e cila jeton në zorë të trashë. Është parazit vetëm i njeriut dhe ngjitet direkt nga njeriu në tjetrin.
- Sëmundja ngjitet përmes vezëve që futen përmes gojës. Skrajat e gjinisë femrore posaqërisht natën kalojnë/dalin nga zora e trashë në regjionin e zgavrës anale për të lëshuar vezët.
- Vezët mbesin të gjalla me javë të tëra p.sh. në çarçafët e shtratit.
- Nga ngjitja e sëmundjes deri te faza e paraqitjes së simptomave zgjatë 1-2 muaj.
- Skrajat anale rëndomtë paraqiten te fëmijët 3-10 vjeçarë, por nuk janë të ralla as infektimet e fëmijëve më të mëdhenj dhe të të riturve me këto.

### Simptomat

- Kruarja e regjionit reth zgavrës anale, posaqërisht natën, që mund të shkakton zgjime nga gjumi natën dhe lagëje të shtratit.
- Grithja/gërvishtja mund të shkakton infektim të lëkurës perianale në bazë të bakterjeve.
- Dobësimi i oreksit dhe iritimi/shqetësimi poashtu mund të lajmërohet.

### Kurimi

- Në barnatore mund të blehet pa përshkrim të mjekut preparati Pyrvin në formë tablete për një përdorim.
- Duhet kujdes i mirë për gjendjen e thonjëve dhe thonjëzët duhet të mbahen të shkurtër.
- Pastrimi i sipërfaqeve në shtëpi.
- Larja e çarçafëve apo ndonji veprim tjetër p.sh. shtrirja e tyre në acar për të shkatëruar vezët e skrajave. Duhet të ndrohen çarçafët.
- Trajtimi me medikamente/ilaçe duhet të përsëritet pasi që të kalojnë 2 javë nga trajtimi i parë.
- Edhe anëtarët e familjes që nuk kanë simptoma është mirë të trajtohen/kurohen.